



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës

Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 pika 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e katërt të rregullt e Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më datë: **27.04.2021** (e martë) duke filluar në ora **10:00**.

R e n d i i d i t ë s


1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-se;
2. Raporti tremujor financiar Janar - Mars 2021;
3. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ne lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 19.04.2021
Në: Novobërdë



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit



Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPSTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tretë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 31.03.2021, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, anëtarët e Kuvendit: Predrag Stojkovic, Ivica Cenic, Dragana Dimic, Negovan Jovanovic, Selatin Nuhui, Dobrivoje Djordjevic, Zymer Zymeri, Jahi Zeqiri, Mirjana Simijonovic, Lirim Gashi, Jorgovanka Filic, Nënkrjetari i Komunës Sinisa Dimic, Drejtori për Zhvillim Ekonomik Adem Abazi, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, Kryetari i Komisionit mbikqyrës të OJQ-ve perfituese Cvetkovic Zoran, Drejtori i Administrates Driton Abdyli, Drejtori i Bujqësisë Sillobodan Savic, Menaxheri i personelit Sylejman Avdyli, përfaqësuesi i OSBE-së dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshendeti të pranishmit tha: para se të fillojm me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë 13 antarë të Kuvendit nga 15 gjithësej, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

R e n d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Raporti tremujor financiar Tetor – Dhjetor 2020;
3. Akitivitetet rreth luftimit të pandemisë Covid 19;
4. Raport nga OJQ, përfituese të mjeteve për ndihmë qytetarëve për shkak të pandemisë Covid 19;
5. Raport nga komisioni për dhënje të pronës në shfrytëzim;
6. Pruarja e vendimit për caktimin e shumës për regjistrimet e mëvonshme të Lindjes dhe Vdekjes;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti antarët e Kuvendit se a pajtoheni me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Ramush Mehmeti pasi përshendeti të pranishmit tha: ne në këtë seanc kemi antrë të ri dhe pika e dytë pas procesverbalit duhet të jetë dhënja e betimit nga anëtari i ri i Kuvendit dhe pika e shtatë duhet të jetë plotësimi në komitetin për komunitete pasi që ai antarë ka qenë edhe në këtë komitet këto dy pika duhet të jenë obligative në këtë seancë

Pasi nuk pati propozime tjera Kryesusi e hudhi në votim rendin e ditës me këto dy pikë shtesë të propozuara.

Më 11 vota për, aprovohet rendi i ditës me këto dy pika shtesë të propozuar: 1. Dhenja e betimit nga antari i ri zëvendësues; 2. Zavendësimi i antarit të lëvizjes vetvendosje në komitetin për komunitete.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje aprovohet procesverbali nga antarët prezent të Kuvendit me 11 vota për.

Pika e dytë: Dhenja e betimit nga antari i ri zëvendësues;

Kryesusi tha: kjo pikë pra është plotësim në rend dite, siç e dini në mbledhjen e kaluar kemi pasuu dorëheqjen e antarit të Vetvendosjes, e kemi marrë edhe vendimin e KQZ i cili thot se Lirim Gashi zavendësohet antarë i Kuvendit nga Lëvizja Vetëvendosje andaj e ftoj antarit e ri të Kuvendit që ta jap betimin, do ta lexoj unë njëherë e ju pas meje.

Unë Lirim Gashi "betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Novobërdës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë".

Pika e tretë: Raporti tremujor financiar Tetor – Dhjetor 2020;

Për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic pasi pershendet të pranishmit tha: shpresoj se materialin e keni marrë me kohë, në fillim të raportit i keni të hyrat për këtë periudh kohore Tetor – Dhjetor 2020, të hyrat në total për këtë periudh kohore kanë qenë 52,697.87€, gjithashtu kemi participim prej qytetarëve në shumë prej 29,389.40€ si dhe donacion prej organizates VORAE 3,480€. Më pastaj i kemi mjetet e shpenzuara, për paga dhe meditje janë shpenzuar 524,546.11€, për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 149,012.71€, për shpenzime komunale janë shpenzuar 34,597.36€, për subvencione janë shpenzuar 262,516.46€ dhe për investime kapitale janë shpenzuar 226,521.24€. Më pastaj i keni edhe shpenzimet për çdo drejtori, nese keni ndonjë pyetje urdhëroni.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: nuk po flas rreth raportit pasi që materiali na ka ardh sot, një material që se lexoj smuj me koment, na ka ardh në email por skam mundur ta lexoj. Mirëpo edhe pse është me vones shumë mirë që ka ardh ky raport, por mendoj se në këtë muaj është duhur që të jetë edhe raporti vjetor financiar.

Sercan Todorovic tha: unë materialin e kam derguar me kohë edhe në KPF nuk e di pse se keni pranuar me kohë, ndërsa sa i përket raportit vjetor financiar, ne deri në fund të janarit punojna në raport vjetor, pastaj kemi një muaj kohë për përmirësime, siç e dini edhe Qeveria e Kosovës ka aprovuar para një muaji raportet financiare për Komunitet dhe besoj që mbledhjen e ardhshme do ta keni edhe raportin vjetor financiar.

Lirim Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: është hera e parë që marrë fjalën në cilsin e asambleistit, më vjen keq që nuk janë drejtorat sot këtu, me vjen keq që nuk është Kryetari i Komunës pasi që në shumicën e seancave që kam marrë pjesë nuk kanë qenë Drejtorat e as Kryetari i Komunës që të dhëjnë llogari para asambleistave dhe para qytetarëve, për mua kjo është e papranueshme, qështje tjetër është mosfunksionimi i paisjeve të perkthimit edhe pse kanë investuar shumë përseri nuk funksionojnë. Po lidhem te raporti financiar nuk e kam të qartë shërbime kontraktuese tjera për çka janë shpenzu?

Sercan Todorovic tha: pagesat janë të ndarë me kode dhe për ato pagesa që nuk ekzistojnë kode kryhen si shërbime kontraktuese tjera, pasi që ka qenë edhe pandemia kemi paguar shumë pako ushqimore për qytetarët dhe pasi që ska pasur kod të veçant janë pagur si shërbime kontraktuese tjera.

Pasi nuk pati tjera diskutime me 4 vota për, 7 kunder (Nebojsa Arsic, Ramush Mehmeti, Lirim Gashi, Selatin Nuhiu, Ivica Cenic, Dragana Dimic, Mirjana Simijonovic) 1 i përmbajtur nuk aprovohet raporti tremujorë financiar Tetor – Dhjetor 2020.

Pika e katërt: Aktivitetet rreth luftimit të pandemisë Covid 19;

Kryesuesi tha: siç e dini situata me pandemi nuk është mirë as në Komunën tonë por siç duket nuk është askush që të raportojë, këtë pikë e kemi planifikuar në çdo mbledhje të Kuvendit në bazë të planit, nese deshiron dikush të merr fjalën urdhëroni.

Ramush Mehmeti tha: pasi që në mbledhje janë disa Drejtorë dhe Nënkryetari është këtu, në mungesë të Kryetarit mundë të merr fjalën Nënkryetari për të na informuar më shumë rreth kësaj gjendje pasi që është pjesë edhe e komisionit emergjent.

Lirim Gashi tha: unë mendoj se për këtë pikë duhet kordinuar Kryetari me Kryesuesin duke e ditur që edhe Kryesuesi është pjesë e shtabit dhe për këtë kishte qenë mirë edhe Kryesuesi me na njoftu se çka është problemi e jo vetëm ti kalohet faji dikujt tjetër.

Pika e pestë: Raport nga OJQ, përfituese të mjeteve për ndihmë qytetarëve për shkak të pandemisë Covid 19;

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalën Kryetarit të komisionit Zoran Cvetkovic.

Zoran Cvetkovic pasi pershendeti të pranishmit tha: në mbledhjen e kaluar ju kam premtuar se do ta sjelli raportin final, komisioni e ka dorëzuar me kohë dhe në mënyrë të sakt raportin që është i dërguar edhe në Ministri të Financave, në këtë raport përfshihet e gjithë puna e OJQ-ve, tregohet qartë se si janë shpenzuar mjetet, tregohet qartë gjithçka në këtë raport që keni kërkuar ju se si janë shpenzuar këto mjete, ku janë shpenzuar dhe sa persona të cilave mosha janë të përfshirë deri më tani. Pasi që e keni marrë materialin më kohë dhe keni pasur kohë ta analizoni urdhëroni nese keni ndonjë pyetje.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: në fillim kur është votu ky buxhet kam qenë kundër, mirëpo kur të shikohet raporti se ku janë shpenzuar këto mjete ky është krim, unë falenderoj Kryetarin e Komisionit që ka përfunduar punën e vet në mënyrë profesionale, por kaq shumë e madhe e mjeteve të shpenzohet për disa pako ndihma, unë personalisht e di se në lagjen time ka ardhë vetëm një paket, mirëpo kemi votuar si Kuvend dhe Kryetari i Komisionit po i raporton Kuvendit kjo është mirë dhe ne vetëm mundë të pajtohemi me këtë, nuk mundë të ndryshojmë asgjë.

Pika e gjashtë: Raport nga komisioni për dhënje të pronës në shfrytëzim;

Kryesuesi tha: nuk kemi asnjë material prej këtij komisioni, i lus antarët e Kuvendit që janë pjesë e atij komisioni të na informojn se çka kanë punuar deri më tani.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: sot është duhur që ta na raportoj kryetarja e komisionit për dhënje të pronës në shfrytëzim, ne atë komisioni jam unë dhe Mirjana Simijonovic, ne kemi mbajtur mbledhje por nuk është marrë asnjë vendim, janë afersisht 12-13 kërkesa prej qytetarëve që kanë kërkuar pronë në shfrytëzim, por fatkeqësisht nuk ka funksionuar ky komision, nuk ka dhënë asnjë pronë deri më tani, ju faleminderit.

Pika e shtatë: Zavendësimi i antarit të lëvizjes vetvendosjes në komitetin për komunitete;

Kryesuesi tha: kjo pikë është plotësim i rendit të ditës për komitetin për komunitete, në vend të Abdyl Gashit i cili ka qenë prej partisë së VV, zëvendësohet me antarin tjetër të Kuvendit i cili është nga e njejta parti politike Lirim Gashi, andaj e hudhi në votim zëvendësimin e antarit të komitetit për komunitete.

Me 9 vota për, 1 apstenim dhe 3 nuk kanë votuar aporpo vëhet kjo pikë nga antarët prezent të Kuvendit dhe bëhet ky:

VENDIM

ZËVENDESOHET antari i Komitetit për Komunitete në vend të Abdyl Gashit zgjedhet Lirim Gashi.

Pika e tetë: Pruarja e vendimit për caktimin e shumës për regjistrimet e mëvonshme të Lindjes dhe Vdekjes;

Kryesuesi për këtë pikë ja dha fjalën Menaxherit të personelit Sylejman Avdyli.

Sylejman Avdyli pasi pershendeti të pranishmit tha: kërkoj sot nga ju që të bëhet një vendim për caktimin e gjobës për regjistrim të mëvonshëm të lindjes dhe të vdekjes. Me ligjin për gjendje civile është e përcaktuar, neni 63, pika 1.1 ku thotë se me gjobë denohet personi për këto shkelje: prej 20-50€ kur personi

nuk e paraqet kur nuk paraqet lindjen e fëmijes në afatin e paraparë me këtë ligj, prej 50-100€ kur nuk e lajmëron vdekjen në afatin e caktuar sipas këtij ligji, unë kerkoj që të bëhet një vendim 20€ me një shumë minimale për lindje ndërsa 50€ për vdekje, ju faleminderit.

Kryesusi tha: a duhet të mirret një vendim apo dy?

Sylejman Avdyli tha: jo, vetem një vendim ku perfshihen të dyjat, por vetem të përcaktohet një shumë fikse.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu tha: propozoj edhe unë që të shkoj shuma minimale 20€ dhe 50€ për vdekje.

Lirim Gashi tha: unë e përkrahi propozimin e Sylejmanit, por kerkoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme në mënyrë që para se ta marrim një vendim ti njoftojmë edhe qytetarët si dhe në këtë pikë të futet edhe varrosja e njerzve që vdesin e shpenzimet i kryen Komuna e jo vetem ti denojmë qytetarët për lindje dhe vdekje që si regjistrojnë me kohë.

Kryesusi tha: faleminderit zt.Gashi por nuk e di a e kuptuat atë që prezantoj Sylejman Avdyli, ne vetem duhet ta plotësojmë rregulloren Komunale që është për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, edhe të organizojmë debate me qytetarë besoj që kishin qenë të pajtuar për gjoha minimale, sa i perket shpenzimeve të vorrimit nuk e di Komuna sa është kompetente që ti mbulojë ato shpenzime.

Zymer Zymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i perket vdekjes gjoha duhet të jetë 100€, për lindje bënë që të jetë 20€, pasi ka raste edhe pas vdekjes marrin pension, ndërsa sa i perket shpenzimeve të vorrimit që e ceki Lirim Gashi ne mundë të marrim vendim por se pari duhet të shkoj në KPF dhe duhet të tregoj Drejtori se ka buxhet të kryehen ato shpenzime apo jo.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesi e hudi në votim vendimin për gjoha të lindjes 20€ dhe të vdekjes 50€.

Me 12 vota për, 1 kunder (Zymer Zymeri) aporovohet kjo pikë nga antarët prezent të Kuvendit dhe bihet ky:

VENDIM

I.Me shumë prej 20 Euro gjositën të gjithë personat kur nuk e paraqesin lindjen e fëmijës në afatin e parapar me ligjë.

I.Me shumë prej:50 Euro gjositën të gjithë personat që nuk e lajmërojnë vdekjen në afatin e paraparë sipas Ligjit Nr.04/L-003 .

Pika e nëntë: Të ndryshme;

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Sllobodan Savic pasi pershendeti të pranishmit tha: ne si Drejtori kemi shumë kërkesa për ndryshimin e kulturës së tokës nga toka bujqësore dhe pyjore në ndertimore, ku ne si Drejtori nuk kemi mundësi që të japim pelqim, ne si Drejtori vetem për klasen e 7 dhe 8 mundë të dhëjmë pelqim pa asnjë vendim të Komunës dhe të Ministrisë. Për kërkesat tjera të pranuar në Drejtorin tonë na duhet edhe vendim i Kuvendit, me këtë vendim ju lehtësohet puna edhe investitorëve, sipas udhëzimit administrativ për klasen 4,5,6 duhet Kuvendi me marr vendim.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë propozim.

Ramush Mehmeti tha: nese ki kërkesa personale për individ të caktuar, Drejtoria e Bujqësisë duhet të vij në Kuvend dhe të thotë se parcela numer kaq është tokë bujqësore dhe duhet të kalojë në tokë ndertimore dhe ne si Kuvend mundë ta përkrahim ose jo, kjo punë në këtë formë shkohet duhet të shkojë në KPF së pari e pastaj të vij në Kuvend.

Selatin Nuhiu tha: unë mendoj se kjo pikë nuk është në rregull që të vij te pika të ndryshme, së pari është duhur që të vij në KPF dhe me pas material se për cilën zonë kadastrale bëhet fjalë?, sa ari ose hektar janë aty?, dhe është duhur që në fillim të hyj në rend dite e jo te pika të ndryshme, për senacen e ardhshme të bihet pika në mënyrë të rregullt dhe me material të kompletuar.

Procesverbali i Kuvendit

Mirjana Simijonovic pasi pershendeti të pranishmit tha: nuk e di si është e mundur të ndryshohet, por në fshatin tim ka shumë ndertime në toka bujqësore ku kan filluar të bëhen toka ndertimore.

Sllobodan Savic tha: ne si Drejtori dhëjmë pelqimin vetem për klasen 7 dhe 8, ndërsa për klasen 4,5,6 shkon procedura përmes Kuvendit.

Mirjana Simijonovic tha: unë kam kerkuar edhe prej znj.Shefkije Mehmeti që të na sjell një raport që të na informoj më shumë rreth kësaj gjendjeje dhe ajo na ka premtuar se do të na sjell raportin por kerkoj edhe nga ju që në mbledhjen e ardhshme me bë një raport pasi që ka shumë biznese që janë hap në fshatin Koretishtë edhe pse janë shenjat se toka është bujqësore.

Kryesusi tha: i kam disa informata prej Drejtorit të kadastrit se autosdrata që është duke u ndertuar në pjesen e Koretishtës dhe Pasjakit aty është kyçja në autostrad andaj kerkoj që të keni kujdes kur ta ridestinoni token nga bujqësorja në ndertimore pasi që ju kushton qytetarëve këto ndryshime.

Dobriwoje Djordjevis pasi pershendeti të pranishmit tha: po e pyes Drejtorin pasi që klasa 4,5,6 ndryshohet me vendim të Kuvendit ndërsa për klasen 3,4,5 që janë ndryshu janë ndërtu çka ka bërë komisioni juaj.

Sllobodan Savic tha: për këtë arsye kam ardhë në Kuvend që të shqyrtohen këto kërkesa.

Dobriwoje Djordjevic tha: ju keni ardh në Kuvend që tju autorizojm që klasen 4,5,6 ta ndrroni kulturen e tokës.

Sllobodan Savic tha: jo nuk kam ardhë për ata, por që ti shqyrtojm kërkesat e qytetarëve.


Lirim Gashi tha: une e di se për çka e ka fjalën Drejtori, e ka fjalën për fshtain Makreshë ku janë duke u bërë disa ndertime, ku për fatkeq aty janë ndërtu objektet por nuk kanë marr leje nga Komuna dhe për këtë po dojnë që ne ta kalojm këtë pikë por unë personalisht nuk do ta votojë, mendoj se duhet me dhënë llogari edhe Drejtoria e Inspeksionit pasi që shumë objekte janë ndërtu në Komunën e Artanës sidomos gjatë vitit 2020 dhe të gjitha janë pa leje dhe po mendojn ta shkatrojnë natyren, por këtë nuk do ta lejojmë pasi që kur ta shikojsh poziten gjeografike të Komunës ka aq bukuri tmira sa nuk mundë ta paremndoni, por disa njëz po e shkatrojnë duke i perfshi prej gurthyvesve në Stanishor e duke ndërtu shtepi pa leje, sikur të kishin pas leje do ta mbeshtesim nese do ta lejonte rregullorja, por pa leje ku janë të përfshirë edhe disa zyrtarë Komunal. Unë personalisht nuk do ta votoj këtë pikë, në do ta mbeshtesim çdo gjë që është në të mirë të qytetarëve. Kerkoj që tjera herë kur të vish të përmendesh se toka në Makreshë duhet të kaloj nga toka bujqësore në ndertimore e jo të përfshihen të gjitha pasi që as asambleistat nuk po e kuptojnë se çka po kerkoni. Kerkoj nga secili asambleist që çdo ndertim që bëhet pa leje të Komunës mos ta votojnë për arsye se ne po i dëmtojmë qytetarët dhe Komunën tonë.

Ramush Mehmeti tha: çdo qytetarë që i drejtohet me kërkes ekzekutivit, dmth Drejtorisë përkatëse ose në emer të Kuvendit, Drejtoritë përkatëse janë kompetente ta shqyrtojnë anen ligjore dhe pastaj tja rekomandojnë Kuvendit me emer dhe mbiemer një kërkes të caktuar.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesuesi i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:20.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit

